

Informacioni për t'u dhënë në dokumentin e mbylljes

- a) hollësi reference të autorizimit;
- b) sasia e çdo tipi mallrash të cilat janë vendosur nën regjimin e posaçëm në lidhje me të cilën pretendohet mbyllja;
- c) kodi NK i mallrave të cilat janë vendosur nën regjimin e posaçëm;
- ç) Niveli i detyrimeve të importit të detyrueshme për mallrat e vëna nën regjimin e posaçëm, dhe vlera e tyre doganore kur është e zbatueshme;
- d) të dhënat e deklaratave doganore që i vënë mallrat nën regjimin e posaçëm;
- dh) tipi dhe sasia e produkteve të përpunuara ose e mallrave të vendosura nën regjim dhe të dhënat e deklaratës doganore pasuese ose e ndonjë dokumenti tjetër në lidhje me mbylljen e regjimit;
- e) kodi NK dhe vlera doganore e produkteve të përpunuara nëse metoda e matjes sasiore përdoret për qëllimin e mbylljes/shkarkimit;
- ë) koeficienti i shfrytëzimit;
- f) shuma e detyrimit të importit për t'u paguar. Kur kjo shumë i referohet aplikimit të Nenit 154(4) duhet të specifikohet;
- g) periudhat për mbylljen.